




**KOMUNA
RAHOVEC**

RAPORT TREMUJOR I PUNËS

ZYRA PËR INFORMIM

JANAR- MARS 2025



ZYRA PËR INFORMIM

Zyra për Informim , gjatë periudhës raportuese, janar-mars 2025, ka vazhduar me përcjelljen e aktiviteteve ditore të Komunës së Rahovecit. Përmes vegës zyrtare: <https://rahovec.rks-gov.net/>

Në webfaqen e Komunës janë publikuar të gjitha aktivitetet e mbajtura dhe janë publikuar të gjitha vendimet, raportet, njoftimet, konkurset dhe dokumente tjera në interes të gjithë qytetarëve të Komunës. Ka mbajtur kontakte të rregullta me media, ku i ka përcjell njoftime e lajme ditore për aktivitetet e zhvilluara në Komunë, ftesa etj. Gjithsej janë përgatitur dhe publikuar 75 lajme, 20 njoftime, 9 ftesa, 3 thirrje, procesverbale 3 dhe 13 konkurse.

Qasja në dokumente publike

Është pranuar gjithsej 1 kërkesë për Qasje në Dokumente Publike dhe i është dhënë qasje dhe ka marrë përgjigje pozitive.

Të gjitha vendimet e nënshkruara nga kryetari i komunës gjatë kësaj periudhe raportuese janë dërguar tek zyrtarët përkatës në MAPL dhe janë publikuar në web faqen zyrtare të komunës. Për këtë periudhë raportuese, kryetari ka nënshkruar 167 vendime.

Është bërë plotësimi i dokumenteve-raporteve si nga ministritë edhe nga OJQ-të e që kanë pasur të bënë me transparencë, performancë dhe llogaridhënie komunale.

Gjatë muajve janar- mars 2025 janë publikuar: aktivitete-dokumente, detajet mund t'i shihni në tabelën e mëposhtme:

Lajme	Njoftime	Ftesa	Thirrje	Konkurse	Rregullore/Plane/Strategji	Takime/Dëgjime/Konsultime	Raportet-procesverbale	Kërkesa QDP	Vendimet e Kryetarit	Aktivitete gjithsej
75	20	9	3	13			3	1	167	291